

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Borislav Kostadinov

Ka lindur në Bullgari, më 16 Tetor 1976. Ai u diplomua me rezultate të shkëlqyera në Shkollën e Gjuhës Angleze (*English Language School*), në Burgas, Bullgari. Ai ka studiuar gjithashtu Administrim Biznesi në Universitetin e Sofjes , Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimi Biznesi .

Ai e filloi karrierën e tij si Këshillues i Burimeve Njerëzore dhe më pas u bashkua në programet e kreditimit për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme të KfW dhe BERZH-it si zëvendës Menaxher i Programit.

Z. Kostadinov ka filluar punën në ProCredit Bank Bullgari në vitin 2001 si menaxher dege. Pas kësaj u transferua në Beograd, si zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Mikrofinanciare, Serbi dhe Mal të Zi.

Si zëvendës Drejtor i Përgjithshëm, z. Kostadinov kishte përgjegjësi për menaxhimin e të gjitha operacioneve të kreditit. Nga 2004 në 2008 ai ishte Drejtor i Përgjithshëm i ProCredit Bank Maqedoni, kur banka përfitoi një licensë të plotë bankare, më 13 Dhjetor 2004.

Në 2008 ai u bë Drejtor Ekzekutiv i ProCredit Bank Shqipëri. Ai ishte gjithashtu anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB), anëtar i Bordit Mbikëqyrës dhe anëtar i Komitetit të Auditimit të ProCredit Bank Bullgari dhe ProCredit Bank Gana .

